



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.996/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit N.P.T. “Arta - Tex” B.I. me NUI: 810410423, me seli në rr. “Bekim Berisha”, në Pejë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Sh.B., avokate nga Peja, kundër debitorit “Selmans Network“ SH.P.K., me NUI: 810815061, me seli në rr. “Jakov Xoxa”, Kompleksi Blini, Co, në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.159/23 të datës 08.06.2023, të Përmbartuesit Privat Shpend Ahmetaj, me seli në Pejë, jashtë seancës, me datë 29.11.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Selmans Network“ SH.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.159/23 i datës 08.06.2023, të Përmbartuesit Privat Shpend Ahmetaj.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr.159/23 i datës 08.06.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Shpend Ahmetaj.
- III. DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim t’ia paguaj kreditorit shumën prej 104.00 € (njëqind e katër euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.159/23 të datës 08.06.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës Nr. 22-SHV01-001-502 të datës 18.10.2022; Faturës Nr. 22-

SHV01-001-492 të datës 12.10.2022; Faturës Nr. 22-SHV01-001-407 e datës 08.09.2022; Faturës Nr. 22-SHV01-001-406 të datës 05.08.2022; Faturës Nr. 22-SHV01-001-417 të datës 18.08.2022; Faturës Nr. 22-SHV01-001-414 të datës 15.08.2022; Faturës Nr. 22-SHV01-001-344 të datës 12.07.2022; Faturës Nr. 22-SHV01-001-256 të datës 03.07.2022; Faturës Nr. 22-SHV01-001-68 e datës 16.03.2022; Faturës Nr. 22-SHV01-001-58 të datës 07.03.2022; Faturës nr.22-SHV01-001-72 të datës 24.02.2022; Faturës Nr. 120821002-3 të datës 08.12.2021; Faturës Nr. 120321003-3 të datës 03.12.2021; Faturës Nr. 101421002-3 të datës 14.10.2021; Faturës Nr. 092121001-3 të datës 21.09.2021; Faturës Nr. 081121001-3 të datës 11.08.2021; Faturës Nr. 071521004-3 të datës 15.07.2021; Faturës Nr. 070221001-4 të datës 02.07.2021; Faturës Nr. 062821001-5 të datës 28.06.2021; Faturës Nr. 053121002-4 të datës 14.06.2021; Faturës Nr. 051421001-5 të datës 14.05.2021; Faturës Nr. 113020001-3 të datës 30.11.2020; Faturës Nr. 101420001-3 të datës 19.10.2020; Faturës Nr. 092320001-3 të datës 23.09.2020; Faturës Nr. 081920001-6 të datës 19.08.2020; Faturës Nr. 072920006-3 të datës 29.07.2020; Faturës Nr. 062420001-3 të datës 24.06.2020; Faturës Nr. 061920001-3 të datës 19.06.2020; Faturës Nr. 052820001-3 të datës 28.05.2020; Faturës Nr. 051220001-3 të datës 12.05.2020; Faturës Nr. 022820002-3 të datës 28.02.2020 dhe Faturës Nr. 062119002-3 të datës 21.06.2019, duke detyruar debitorin që në emër të përmbushjes së obligimeve nga fatura e lartcekur që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri t'ia paguaj kreditorit shumën prej 9,578.50 €, me kamatë ligjore prej 8 %, nga dita e kalimit të afatit për pagesë e deri në pagesën definitive, si dhe t'i paguajë shpenzimet e procedurës përbarimore, në të kundërtën organi përbarues do të bëjë përmbushjen e ekzekutimit me dhunë me ndalimin e mjeteve monetare të cilat debitori i ka në llogaritë bankare, si dhe me regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përbarimor duke theksuar ndër të tjerash se faturat nuk i përmbajnë të gjitha kushtet ligjore për tu konsideruar si dokumente të besueshme, ngase këto fatura nuk përmbajnë afatin për pagesë duke mos i dhënë asnjë mundësi debitorit për përmbushje vullnetare, po ashtu disa nga fatura nuk përmbajnë as adresën e debitorit, ashtu që nuk dihet se në cilin vend kreditori e ka dërguar mallin. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri përbarimor dhe të përfundohet në tërësi përbarimi në këtë çështje përbarimore.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka kundërshtuar në tërësi thëniet e debitorit në prapësim, duke theksuar që debitori nuk ka arritur që me asnjë provë të vetme të vërtetojë pretendimet e tij dhe se qëllimi i vetëm është vonesa dhe shtyrja e përmbarimit. Më tutje ka shtuar përmbaruesi privat ka caktuar përmbarimin duke u bazuar në dokumentin e besueshëm, përkatësisht faturat të cilat i janë dorëzuar debitorit dhe të njëjtat janë nënshkruar nga personat e autorizuar të debitorit me rastin e pranimit të mallit. Në lidhje me pretendimet e debitorit rreth afatit të pagesës dhe adresës së pasaktë, të njëjtat i ka kundërshtuar duke deklaruar se afati i përmbushjes vullnetare të detyrimit caktohet me anë të aktvendimit përkatësisht urdhrin për përmbarim dhe se në çdo faturë ceket adresa e debitorit. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pa bazuar prapësimi i debitorit, urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi, si dhe të detyrohet debitori që t'i paguajë shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim në lartësi prej 104.00 € sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës (OAK).

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe përgjigjes në prapësim të kreditorit si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit

1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - Faturën Nr. 22-SHV01-001-502 të datës 18.10.2022; Faturën Nr. 22-SHV01-001-492 të datës 12.10.2022; Faturën Nr. 22-SHV01-001-407 e datës 08.09.2022; Faturën Nr. 22-SHV01-001-406 të datës 05.08.2022; Faturën Nr. 22-SHV01-001-417 të datës 18.08.2022; Faturën Nr. 22-SHV01-001-414 të datës 15.08.2022; Faturën Nr. 22-SHV01-001-344 të datës 12.07.2022; Faturën Nr. 22-SHV01-001-256 të datës 03.07.2022; Faturën Nr. 22-SHV01-001-68 e datës 16.03.2022; Faturën Nr. 22-SHV01-001-58 të datës 07.03.2022; Faturën nr.22-SHV01-001-72 të datës 24.02.2022; Faturën Nr. 120821002-3 të datës 08.12.2021; Faturën Nr. 120321003-3 të datës 03.12.2021; Faturën Nr. 101421002-3 të datës 14.10.2021; Faturën Nr. 092121001-3 të datës 21.09.2021; Faturën Nr. 081121001-3 të datës 11.08.2021; Faturën Nr. 071521004-3 të datës 15.07.2021; Faturën Nr. 070221001-4 të datës 02.07.2021; Faturën Nr. 062821001-5 të datës 28.06.2021; Faturën Nr. 053121002-4 të datës 14.06.2021; Faturën Nr. 051421001-5 të datës 14.05.2021; Faturën Nr. 113020001-3 të datës 30.11.2020; Faturën Nr. 101420001-3 të datës 19.10.2020; Faturën Nr. 092320001-3 të datës 23.09.2020; Faturën Nr. 081920001-6 të datës 19.08.2020; Faturën Nr. 072920006-3 të datës 29.07.2020; Faturën Nr. 062420001-3 të datës 24.06.2020; Faturën Nr. 061920001-3 të datës 19.06.2020; Faturën Nr. 052820001-3 të datës 28.05.2020; Faturën Nr. 051220001-3 të datës 12.05.2020; Faturën Nr. 022820002-3 të datës 28.02.2020 dhe Faturën Nr. 062119002-3 të datës 21.06.2019; i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave është përcaktuar shuma e cila përben detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Gjykata po ashtu vlerësoi pretendimet e debitorit se në faturën e kreditorit nuk është treguar koha e përmbushjes së detyrimit monetar dhe gjeti se e njëjta nuk gjen mbështetje ligjore, sepse në rastin konkret fatura i plotëson kushtet e përcaktuara për zbatimin e përbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm për faktin se afati i përmbushjes së detyrimit është përcaktuar në faturë dhe në propozimin për përbarim siç parashihet me dispozitën e nenit 40 par 1.2 të LPP-së, i cili

përcakton se: *“1.Propozimi për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm duhet të përmbajë:... kërkesën që organi përmbarues ta detyrojë debitorin e përmbarimit që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh, kurse në kontestet nga raportet ku ekziston kambiali dhe çeku brenda afatit prej tre (3) ditësh, nga dita në të cilën i dorëzohet aktvendimi ta përmbushë detyrimin bashkë me shpenzimet e caktuara...”*. Për më tepër fatura e cila nuk përmban afat të përmbushjes nga data e lëshimit të faturës, nënkuptohet se afati për përmbushje arrin menjëherë respektivisht në datën e lëshimit të faturës.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarimi.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, mbajnë nënshkrimin e debitorit, si dhe nuk janë kontestuar asnjëherë nga debitori.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbarimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke i'a njohur shpenzimet e të autorizuarit të kreditorit për përpilimin e përgjigjes në prapësim dhe atë në shumën prej 104.00 € (njëqind katër euro), siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifën e avokatëve, të datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.996/23, datë 29.11.2023

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.